



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 5447 Prot.

Tiranë, më 6 . 10 . 2021

URDHËR

NR. 395, DATË 6 . 10 . 2021

PËR

**NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN NR. 166, DATË 17.06.2021, "PËR
CAKTIMIN E DATËS SË FILLIMIT DHE MBARIMIT TË VITIT AKADEMIK 2021 -
2022 NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË"**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, germës "i" të pikës 2 të nenit 7 dhe të pikës 1 të nenit 87 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Pika 1 e urdhrit nr. 166, datë 17.06.2021, bazuar në propozimin e Konferencës së Rektorëve të datës 05.10.2021, ndryshon si më poshtë:

"Fillimin e vitit akademik 2021 - 2022 në institucionet e arsimit të lartë, në datën 18 tetor 2021 dhe mbarimin e tij në datën 30 shtator 2022".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

EVIS KUSHI

